



Ministria e Bujqësisë,
Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
Trupi për menaxhim me IPARD

Programi IPARD 2014-2020

Masa 7

DIVERSIFIKIMI I FERMAVE
DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE

MUNDËSI
EVROPIANE
PËR BUJQËSINË
MAQEDONASE
DHE ZHVILLIMIN
RURAL



Ky projekt është financuar nga
Bashkimi Europian

Instrumenti për Ndhmë Paraaderuese për Zhvillimin Rural (IPARD) 2014-2020

Këtë projekt e implementon Trupi për menaxhim me IPARD

rr. Aminta III nr. 2, Shkup

Financuar nga masa - Ndhmë teknike nga Programi IPARD 2014-2020



DIVERSIFIKIMI I FERMAVE DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE (MASA 7)

I. Përdorues

- Persona fizikë;
- Persona juridikë (ndërmarrje të vogla dhe mikro);
- Kooperativa

II. Sektorë prioritarë

- **Prodhimi bujqësor alternativ** – (kultivimi i kërpudhave dhe tartufave, hortikultura, prodhimi i materialit faror dhe për mbëltrim, kultivimi i lepujve, kërmijve, zogjve për vezë dhe mish – rosave, patate, pulave të detit, strucëve, ëmave dhe pulave afrikane, kafshëve të gjahut, bletëve, kultivimi i bimëve për erëza dhe aromatike, fidanëve për dru dhe biomasë (me rritje të shpejtë), ferma akuakulturë për peshq të ujërave të ëmbla;
- Prodhim të **produkteve ushqimore dhe pijeve** – (me përjashtim të investimeve që janë të pranueshme sipas masave tjera të programit IPARD);
- Prodhimi i **produkteve joushqimore** – (të gjitha veprimtaritë në pajtim me listën e veprimtarive e cila është Shtojcë 14 e programit IPARD);
- Zhvillimi i **aktiviteteve të zejtarisë** - (në pajtim me Rregulloren për mënyrën e caktimit të aktiviteteve që mund të kryhen me zejtari);
- Sigurimi i **shërbimeve në bujqësinë** – (veprimtari veterinarë, punëtori për mirëmbajtje dhe riparim të mekanizmit dhe pajisjes bujqësore, shërbime për marrje me qira të mekanizmit dhe makinave bujqësore);
- Zhvillimi i **shërbimeve për popullatë rurale** – (shërbime për riparim dhe mirëmbajtje, për qëndrim, dhe kujdes (azil i pleqve, shtëpi e rehabilitimit etj), për përkujdesje ditore të fëmijëve, qendra arsimore, informative, sportive-rekreative etj);
- Promovimi i **turizmit rural** – (akomodimi në dhoma, apartamente, kampe, baraka, gatim dhe shërbim të ushqimit, dhoma për degustim/shitje, muze rurale, hapësira për seminare/trajnime, ferma edukative, aktivitete rekreative për turistë);
- Prodhim dhe **shitje të energjisë nga burime të rinovueshme** (energji diellore dhe me erë, përpunimi i produkteve kafshore nga biomasa primare dhe sekondare, përveç biomasës të produkteve të peshqve, prodhim të bio-karburantit, përpunim të biomasës pyjore).



III. Standarde

Në fund të investimit nevojitet të arrihen standardet nacionale minimale për:

- Shëndet publik;
- Mirëqenie të kafshëve;
- Siguri të ushqimit;
- Mbrojtje në punë;
- Mbrojtje të mjedisit jetësor.

Varësisht nga veprimtaria ekonomike specifike të kërkuesit nevojitet që në fund të investimit të plotësohen të gjitha kërkesat në pajtim me legjislacionin nacional.

IV. Pronësia e tokës/objekteve

Për tokën dhe/ose objektet që janë lëndë e investimit kërkuesi duhet të dëshmojë:

- **Pronësi** ose
- **Marrëveshje për qira** (së paku **7 vjet** nga dita e parashtrimit të kërkesës);

V. Kriteret specifike

Investimet në ndërtim/rikonstruktim për qëllime turistike në mjediset rurale doemos duhet ta ndjekin **stilin tradicional të ndërtimit**.

Nëse kërkuesi është **person fizik**, investimet në ndërtim/rikonstruktim për qëllime turistike për akomodim dhe/ose shërbime të restorantit janë kufizuar në:

- **10 dhoma (20 mysafirë)**
- **10 njësi akomoduese për akomodim në vend të hapur (30 mysafirë)**
- **50 mysafirë për shërbime të restorantit.**

Nëse kërkuesi është person juridik, investimet në ndërtim/rikonstruktim për qëllime turistike dhe/ose shërbime të restorantit janë kufizuar në:

- **20 dhoma (50 mysafirë)**
- **30 njësi akomoduese për akomodim në vend të hapur (90 mysafirë)**
- **150 mysafirë për shërbime të restorantit.**

VII. Investime të pranueshme

- Ndërtim/rikonstruktim të objekteve dhe pronës tjetër të patundshme që përdoret për aktivitete të pranueshme ekonomike;
- Furnizim dhe/ose instalim të makinave dhe pajisjes së re lidhur me aktivitetin e pranueshëm ekonomik;
- Furnizimin e rezervarëve dhe rimorkiove transportuese
- Furnizimi i drunjve dhe bimëve shumëvjeçare (me përjashtim të farës, materialit për mbëltim dhe miceliumit);
- Furnizimi i makinave dhe pajisjes së re për mbrojtje të mjedisit jetësor përfshirë pajisje për prodhim të energjisë elektrike dhe/ose ngrohjes me shfrytëzim të burimeve të rinovueshme të energjisë;
- Rregullimi infrastrukturor.

Investimet e ardhshme

Kërkuesit mund të parashtojnë më shumë projekte në kuadër të kësaj mase gjatë realizimit të Programit, me kusht që shpenzimet e pranueshme totale maksimale (**deri 1.500.000 euro**) të mos tejkalohen dhe të realizohen projektet paraprake (t'i paguhen shfrytëzuesit).



VI. Qëndrueshmëria ekonomike

Qëndrueshmërinë ekonomike e investimit kërkuesi e dëshmon përmes:

- **Propozim-projektit teknik** (për investime deri në **50.000 euro**);
- **Planit afarist** (për investime mbi **50.000 euro**).



VIII. Lartësia e mbështetjes

Lartësia e mbështetjes financiare është 65% nga shpenzimet e pranueshme totale të investimit.

- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme totale për projektin investues – **1.500 euro**.
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme totale për projektin investues - **1.000.000 euro**.





Ministria e Bujqësisë,
Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
Trupi për menaxhim me IPARD

Formularët e nevojshëm për aplikim mund të merren në:

Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave

Tel.: 02/3134-477 lokali 113,114,115, Sektori IPARD

Adresa: Aminta III nr.2, Shkup,

www.ipard.gov.mk

Agjencinë për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tel.: 02/3097-460

Adresa: Brigada e III-të Maqedonase p.n., Shkup

www.ipardpa.gov.mk

Agjencinë për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë

Tel.: 047/228-330 dhe 047/228-370

Adresa: Kliment Ohridski p.n, Pellagonka II-5/3, Manastir

www.agencija.gov.mk

www.ipard.gov.mk, www.ipardpa.gov.mk

Instrumenti për Ndihmë Paraaderuese për Zhvillimin Rural (IPARD) 2014-2020

Këtë projekt e implementon Trupi për menaxhim me IPARD

rr. Aminta III nr. 2, Shkup

Financuar nga masa - Ndihmë teknike nga Programi IPARD 2014-2020



Ky projekt është financuar nga
Bashkimi Europian

